POSTIM ARKIVOR

# Dokumente të Arkivit të Sigurimit të Shtetit mbi zhvillimet politike dhe shoqërore të vitit 1991

Protestat në Elbasan, Kavajë e Shkoder sipas Sigurimit të Shtetit




SEKSIONI

1970-1991

PERIUDHA

1991 - 1991

Në Arkivin e Sigurimit të Shtetit ndodhen një sërë dosjesh dokumentare që pasqyrojnë situatën politike, shoqërore dhe të sigurisë në Shqipëri gjatë vitit 1991, një periudhë e karakterizuar nga ndryshime të thella dhe tensione të shumta. Këto materiale përmbajnë informacione operative, raporte dhe analiza mbi zhvillimet kryesore, duke evidentuar reagimet e institucioneve shtetërore ndaj protestave, grevave dhe lëvizjeve me karakter politik.

PROTESTA

# N5 [illegible] 5-5"5 5%

14 janar 1990, Shkodër – Zhvillohet demonstrata e parë antikomuniste; tentohet rrëzimi i bustit të Stalinit dhe organizatorët arrestohen. 22 janar 1990, Plenumi i 9-të – Ramiz Alia flet për “përsosjen e demokracisë socialiste”, ndërsa pranon ndryshimet në Europën Lindore. 26 janar 1990 – Ramiz Alia deklaron se Shqipëria është “kala e pamposhtur”, duke mohuar ndikimin e protestave. 28 janar 1990, Tiranë – Zhvillohet protesta e parë në kryeqytet; shteti reagon me masa të forta dhe ndalime. 25 shkurt 1990 – Tre të rinj tentojnë të arratisen; dy vriten nga kufiri, një mbijeton. 25 mars 1990, Kavajë – Protesta në stadium kundër diktaturës shoqërohet me përplasje dhe arrestime. 2 korrik 1990 – Mbi 5000 shqiptarë hyjnë në ambasada të huaja për azil; nis eksodi masiv. 8 dhjetor 1990 – Studentët nisin protestat për pluralizëm dhe reforma demokratike. 11–12 dhjetor 1990 – Krijohet Partia Demokratike si forca e parë opozitare. 14 dhjetor 1990, Elbasan – Protestë e madhe antikomuniste me thirrje për liri dhe rrëzimin e regjimit. 16 dhjetor 1990, Qafë Bari – Minatorët hyjnë në grevë për kushte më të mira dhe paga. 12–16 janar 1991, Valias – Greva e minatorëve sjell rritje pagash dhe forcon presionin ndaj regjimit. 22 janar 1991 – Ramiz Alia nxjerr dekret për mbrojtjen e monumenteve, për të ruajtur figurën e Enver Hoxha . 12 shkurt 1991, Gjirokastër – Studentët bojkotojnë mësimin dhe kërkojnë ndryshime. 14 shkurt 1991, Kamëz – Studentët protestojnë për kushte ekonomike dhe mbështeten nga studentët e Tiranës. 18 shkurt 1991 – Studentët hyjnë në grevë urie për heqjen e emrit të Enver Hoxhës nga universiteti. 19 shkurt 1991 – Sindikatat paralajmërojnë protesta masive në mbështetje të studentëve. 20 shkurt 1991, Tiranë – Populli rrëzon monumentin e Enver Hoxhës, simbol i rënies së regjimit. 21 shkurt 1991 – Krijohen “Vullnetarët e Enverit” dhe tensionet rrezikojnë përplasje të armatosura. 22 shkurt 1991, Gjirokastër – Studentët sulmohen dhunshëm nga mbështetësit e regjimit pasi rrëzojnë bustin e Hoxhës. BURIMI: Profili zyrtar në Facebook i Autoritetit të Dosjeve

PERMBAJTJE #2

# Dosjet e Sigurimit të Shtetit (1991): Nga Protestat Sociale te Kriza Politike dhe Rënia e Regjimit

Në Arkivin e Sigurimit të Shtetit ndodhen një sërë dosjesh dokumentare që pasqyrojnë situatën politike, shoqërore dhe të sigurisë në Shqipëri gjatë vitit 1991, një periudhë e karakterizuar nga ndryshime të thella dhe tensione të shumta. Këto materiale përmbajnë informacione operative, raporte dhe analiza mbi zhvillimet kryesore, duke evidentuar reagimet e institucioneve shtetërore ndaj protestave, grevave dhe lëvizjeve me karakter politik. Dosja 113 (janar–korrik 1991) – Tregon rritjen e protestave dhe grevave që kalojnë nga kërkesa ekonomike në politike, me përfshirje të studentëve, punëtorëve dhe sindikatave. Dosja 114 (janar–korrik 1991) – Evidenton radikalizim të situatës, protesta më të ashpra, thirrje kundër regjimit dhe rrezik destabilizimi. Dosja 117 (mars 1991) – Analizon dobësitë e shtetit në përballimin e krizës dhe nevojën për reforma në organet e rendit. Dosja 119 (janar–korrik 1991) – Dokumenton protesta kundër regjimit (si rrëzimi i bustit), përfshirje të opozitës dhe rrezik për përshkallëzim konfliktesh.

MEDIA #1

# Shkrese me 2 faqe nga Dosja nr. 113 e vitit 1991

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË — Sekret
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME — Ekzemplar nr......
DREJTORIA I
Nr. ______ — Tiranë, më ________1991.

Lënda : Për disa të dhëna në përkrahje të kërkesave të studentëve të universitetit.

Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, na informon se nga të dhënat e informacionet e marra, rezulton se persona të veçantë përpiqen të inspirojnë sa më shumë njerëz në përkrahje të kërkesave të studentëve, e kryesisht nxënësit e shkollave dhe ndërmarrjeve të ndryshme të Tiranës.

Kështu, nxënës të shkollave të mesme "Çajupi", "Partizani" të Shkollës së Konfeksioneve në Kombinat, të Shkollës së Mesme Elektrike, shprehen se ne përkrahim kërkesat e studentëve për bojkotimin e mësimit dhe do të vazhdojmë t'i mbështesim ata dhe në fakt, më datën 15.2.1991 në këto shkolla nga shumë nxënës është bojkotuar mësimi. Gjithashtu, nxënës të veçantë mbledhin firma ndër shokët e tyre, kryesisht djemve, të cilët edhe kanë firmosur, ndërsa vajzat jo. Kurse në shkollat e mesme "Partizani" dhe "Çajupi" kanë shkuar dy studentë të universitetit për të mbledhur firma për të hequr nga mësimi lëndët e Historisë së PPSH dhe Materializmin Dialektik e Historik, duke ju thënë,"se pas dy vjetësh do të jeni ju në vendin tonë në universitet e do t'i keni në kurriz këto lëndë".

Po kështu, edhe nxënësit e klasave të VII e VIII të shkollës 8 vjeçare "Xhezmi Delli", shprehen në përkrahje të kërkesave

Shkrese me 2 faqe nga Dosja nr. 113 e vitit 1991

MEDIA FAQE #2



2.

të studentëve. Bile shumë nxënës, më datën 15.2.1991 kanë bojkotuar mësimin dhe janë shprehur, se "edhe më datën 18.2.1991, do të mblidhen tek sheshi "Demokracia", në përkrahje të studentëve".

Në vazhdim të këtyre veprimeve, në Tiranë është përhapur lajmi, "se ditën e djelë, datë 17.2.1991, studentët që banojnë në konvikte nuk do të paraqiten në menca për të ngrënë bukë, por do të shpallin grevën e urisë, sepse nuk po u plotësohen kërkesat nga Qeveria".

Edhe në ndërmarrje të veçanta, si në Kombinatin e Autotraktorëve, Uzinën "Dinamo", NSHRAK, Kombinatin e Tekstileve, etj., anëtarë e simpatizantë të Partisë Demokratike punojnë për të ngritur punëtorët në përkrahje të kërkesave të studentëve. Kështu, Flamur Hatellari e Lendi Kodra, në Kombinatin e Tekstileve, shprehen : "Jemi në përkrahje të studentëve dhe do të përkrahim të gjitha kërkesat e tyre politike dhe ekonomike, bile kryetari i sindikatës është këlysh i PPSH, prandaj duhet hequr".

Ndërsa punonjës të Kombinatit të Autotraktorëve, nën drejtimin e Edmond Kotonit, kanë bërë një peticion dhe ia kanë nisur Kuvendit Popullor, ku kërkojnë heqjen e emrit të Enver Hoxhës këtij kombinati. Të njejtin veprim kanë bërë edhe punonjësit e NSHRAK-ut.

Një burimi ynë informon, se "në Uzinën e vjetër "Dinamo" është bërë një mbledhje e punëtorëve, nën ndikimin e inxhinier Piro Kaltanjit, ku Azem Hajdari u bëri thirrje, që të mos e besonin më udhëheqësin kryesor të Partisë së Punës, pasi i "gënjen" dhe se vazhdimisht ai i ka "gënjyer".

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
HEKURAN ISAI

INFORMACION

## Shkrese me 2 faqe nga Dosja nr. 113 e vitit 1991

| | |
|---|---|
| FONDI | 4 |
| DOSJA | 113 |
| VITET EKSTREME | 1991 |
| STRUKTURA | Drejtoria e I-rë |
| SASIA E FLETËVE | 26 |
| GJUHA | shqip |
| LIDHJA | Rrezimi i permendores se E.Hoxhes, protestat studentore, renia e regjimit |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Informate |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

# Letër e dt. 22.01.1991 drejtuar Drejtorisë së Parë të Punëve të Brendshme nga Drejtori i Drejtorisë së parë Sahedin Bardhi

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPERISE — S E K R E T

MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME — Ekzemplar Nr.1.

DREJTORIA E PUNEVE TE BRENDSHME 405 22.1.91 . Tiranë, 22.1.1991

Nr. 180

I N F O R M A C I O N

MINISTRIS PUNEVE TË BRENDSHME

DREJTORISË PARË

T I R A N Ë

Nga sinjalizimi i një studenti në UT "E.Hoxha", në Fakultetin e Histori-Filologjis, më daten 21.1.1991 në pushimin ndërmjetës persona të ndryshëm kanë shkuar nëpër klasa dhe u kanë bërë thirrje studentëve që për 3 ditë më datat 22,23,24 Janar 1991 të lënë mësimin dhe të grumbullohen tek qyteti i studentëve, pa u spjeguar se për çfarë arsye dhe se çfarë do bëhej gjatë këtij grumbullimi.

Nga ana e jonë janë marrë masat e nevojshme për verifikimin e kësaj të dhëne, të personave që kanë bërë thirrjen e mësipërme, dhe masat e tjera të nevojshme parandaluese.

... I PUNEVE TË BRENDSHME

...HEDIN BARDHI

AIDSSH

Letër e dt. 22.01.1991 drejtuar Drejtorisë së Parë të Punëve të Brendshme nga Drejtori i Drejtorisë së parë Sahedin Bardhi

INFORMACION

## Letër e dt. 22.01.1991 drejtuar Drejtorisë së Parë të Punëve të Brendshme nga Drejtori i Drejtorisë së parë Sahedin Bardhi

| | |
|---|---|
| FONDI | 4 |
| STRUKTURA | Drejtoria e I-rë |
| DOSJA | 113 |
| VITET EKSTREME | 1991 |
| SASIA E FLETËVE | 26 |
| DATA E KRIJIMIT | 22.01.1991 |
| GJUHA | shqip |

| | |
|---|---|
| LLOJI I DOKUMENTIT | Informatë |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

# Letër e datës 13 .02.1991 nga Dosja nr.114/e vitit 1991 "Per disa shqetesime te tjera ne qytetin e Kavajes"

MEDIA FAQE #1



11 16

REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA I
Nr. 984

S e k r e t
Ekzemplar nr....3...

Tiranë, më 13. 2. 1991.

L ë n d a : Për disa shqetësime të tjera në qytetin e Kavajës.

SHOKUT: RAMIZ DHE ADIL

Nga informacionet e marra, rezulton se gjatë muajit janar e në vazhdim në qytetin e Kavajës, po kryhen akte të kundraligjshme, bëhen grumbullime të personave të veçantë, bile edhe në orët e vona të natës, ku bërtasin e hedhin parulla kundër pushtetit popullor, sistemit komunist e Partisë së Punës. Po ashtu, kanë shkruar disa parulla në vende publike me përmbajtje të tillë dhe kundër figurës e personalitetit të shokut Enver Hoxha.

Kështu, gjatë muajit janar, grupe personash janë grumbulluar në vende të ndryshme, si në Lagjen nr.1 (Sallbeg) tek sheshi i qytetit, në fushën e sportit dhe duke qëndruar në errësirë thërrisnin "Liri-Demokraci", "Poshtë Qeveria", "Themeluesi i Partisë ishte Hitler", etj. Ndërsa më datën 16.1.1991, në qendër të qytetit u grumbulluan shumë qytetarë ku prisnin shitjen e gazetës "Rilindja Demokratike", kur komiteti ekzekutiv dha porosi që kjo gazetë të mos shitej në librarinë qendrore të qytetit, por në periferi, rreth 1000 vetë marshuan nëpër qytet, duke thirrur "Liri-Demokraci", "Eja mblidhu ni këtu-këtu", "Enver-Hitler" dhe mandej filluan të grisnin veprat duke i shpërndarë nëpër rrugë. Organet e Policisë ndërhynë për t'i shpërndarë, duke aktivizuar edhe persona me ndikim ndaj tyre.

Letër e datës 13 .02.1991 nga Dosja nr.114/e vitit 1991 "Per disa shqetesime te tjera ne qytetin e Kavajes"

MEDIA FAQE #2



2.

Po kështu edhe gjatë ditëve të zhvillimit të ndeshjeve të futbollit masa të mëdha sportdashësish, kryesisht fëmijë dhe të rinj, në mënyrë të organizuar dhe demonstrative si në stadium dhe kur dalin në rrugë jo vetëm që përdorin fjalë fyese ndaj qytetarëve, por edhe hedhin parulla si, "Duam liri-demokraci", "poshtë qeveria", "komunizmi mori fund" si dhe grisin veprat e fyejnë figurën e shokut Enver Hoxha, duke përdorur edhe barcaleta të ndryshme. Kështu u veprua edhe në ndeshjen me ekipin e "Labinotit" të Elbasanit, dhe kur policia ndërhyri për t'i shpërndarë u qëlluan me gurë për rreth 30 minuta dhe u shpërndanë vetëm kur policia u detyrua të tërhiqet për t'u mbrojtur.

Gjithashtu, në disa pallate në Lagjen nr.1, në murin rrethues të shkollës 8-vjeçare "Tre dëshmorët" në disa baraka fruta-perime të Lagjes nr.3, persona të paidentifikuar kanë shkruar parulla të karakterit që përmendëm, me bojë të zezë, të cilat akoma nuk janë fshirë, megjithë ndërhyrjen e bërë pranë Komitetit Ekzekutiv të qytetit.

Theksojmë, se edhe gjatë kryerjes së shërbimit natën, post rojet e policisë qëllohen me gurë nga persona të veçantë, dhe më e keqja është se nuk gjejnë as përkrahjen e opinionit, kur identifikohet ndonjëri prej tyre.

I PUNËVE TË BRENDSHME
KURAN ISAI

Letër e datës 13 .02.1991 nga Dosja nr.114/e vitit 1991 "Per disa shqetesime te tjera ne qytetin e Kavajes"

INFORMACION

## Letër e datës 13 .02.1991 nga Dosja nr.114/e vitit 1991 "Per disa shqetesime te tjera ne qytetin e Kavajes"

| | |
|---|---|
| FONDI | 4 |
| STRUKTURA | Drejtoria e I-rë |
| DOSJA | 114 |
| VITET EKSTREME | 1991 |
| DATA E KRIJIMIT | 13.02.1991 |
| GJUHA | Shqip |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Informate |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

# Letër e dt 13.02.1991 nga Hekuran Isai drejtuar Ramiz Alisë

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË — Sekret
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME — Ekzemplar nr. 2
DREJTORIA I
NR. 976. — Tiranë, më 13. 2. 1991

Lënda: Për organizimin e disa veprimeve të mprehta armiqësore.

KRYETARIT TË PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR
SHOKUT RAMIZ ALIA
TIRANË

Ditët e fundit elementë armiq e rrugaç, flasin hapur se më datën 13 dhe 15 shkurt 1991, do të grumbullohen në Tiranë persona të ndryshëm nga të gjithë rrethet e vendit, të cilët fillimisht do të sulmojnë rajonin e banimit të udhëheqjes, për t'larguar prej andej ata që banojnë aty e më pas do të grumbullohen në qendër të qytetit ku do të kërkojnë me forcë rrëzimin e qeverisë. Gjithashtu shprehen se gjatë këtyre ditëve do të kryhen veprime që të shpërthejë lufta civile në Shqipëri.

Ndërsa nga Shkodra informohemi, se atje flitet që së afërmi do të kryhen veprime si ato të muajit dhjetor 1990. Këtë punë do ta fillojnë me organizimin e studentëve të Institutit të Lartë Pedagogjik.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
HEKURAN ISAI

AIDSSH

Letër e dt 13.02.1991 nga Hekuran Isai drejtuar Ramiz Alisë

INFORMACION

## Letër e dt 13.02.1991 nga Hekuran Isai drejtuar Ramiz Alisë

| | |
|---|---|
| FONDI | 4 |
| STRUKTURA | |
| DOSJA | 114 |
| VITET EKSTREME | 1991 |
| SASIA E FLETËVE | 21 |
| DATA E KRIJIMIT | 13.02.1991 |
| GJUHA | Shqip |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Informatë |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #5

# Letër e datës 14.021991 drejtuar Ramiz Alisë, nga Ministri i Brendshëm Hekuran Isai

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË — Sekret

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME — Ekzemplar nr. 1

DREJTORIA I

NR. 1000 — Tiranë, më 14. 2. 1991

Lënda: Për organizimin e një demonstrate.

KRYETARIT TË PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR
SHOKUT RAMIZ ALIA
TIRANË

Dega e Punëve të Brendshme Pogradec, na njofton se persona të paidentifikuar janë shprehur, se më 15-16 shkurt në Tiranë, tek Selia e Komitetit Qëndror të PPSH, Partia Demokratike do të organizojë një demonstratë të madhe dhe do të kryejnë akte vandalizmi me synim dorëheqjen e qeverisë.

Ndërsa një person tjetër në Tiranë, është shprehur, se më datën 15 e 16.2.1991 do të jenë objekt sulmi dikasteret shtetërore, por në radhë të parë Blloku i banesave të kuadrove kryesorë të Partisë së Punës e të shtetit.

Nga burimet tona, vazhdojnë të vijnë informacione, se në Tiranë po futen armë zjarri dhe se këto kryesisht dërgohen ilegalisht nga Kavaja dhe Shkodra. Personat që i sjellin këto armë i fshehin nëpër lidhjet e tyre familjare e miqësore.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
HEKURAN ISAI

Letër e datës 14.021991 drejtuar Ramiz Alisë, nga Ministri i Brendshëm Hekuran Isai

INFORMACION

## Letër e datës 14.021991 drejtuar Ramiz Alisë, nga Ministri i Brendshëm Hekuran Isai

| | |
|---|---|
| FONDI | 4 |
| STRUKTURA | Drejtoria e I-rë |
| DOSJA | 119 |
| VITET EKSTREME | 1991 |
| SASIA E FLETËVE | 50 |
| DATA E KRIJIMIT | 14.02.1991 |
| GJUHA | Shqip |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Informatë |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #6

# Letër e dt 13.02.1991 nga Hekuran Isai drejtuar Ramiz Alisë

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË — Sekret
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME — Ekzemplar nr. 6
DREJTORIA I
NR. 812 — Tiranë, më 11. 2. 1991

Lënda: Për organizimin e një demonstrate në qytetin e Tiranës.

SEKRETARIT TË PARË TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH
SHOKUT RAMIZ ALIA
TIRANË

Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, na informon se në mjedise të ndryshme qarkullon mendimi se më datën 16 shkurt 1991, do të bëhet një demonstratë e madhe nga populli. Demonstruesit nuk do të shkojnë në vendin e caktuar nga policia, por do të grumbullohen në sheshin "Skënderbej", ku do të ndërmarrin veprime vandaliste për heqjen e monumentit të Enver Hoxhës. Ndërsa në linjën e autobuzit të porcelanit, disa persona gjatë bisedës janë shprehur, se më datën 16.2.1991 do të bëhet demonstratë e përgjithshme në të gjithë Shqipërinë.

Në Kombinatin e Autotraktorëve "Enver Hoxha" në repartin e fonderisë së çelikut, një inxhinier u merr firmat punëtorëve të këtij reparti për t'i hequr emrin e Themeluesit të Partisë këtij kombinati. Veprime të tilla bëhen edhe në uzinat e tjera të kombinatit.

Po marrim masa për vërtetimin e informacionit dhe parandalimin e veprimeve që mund të ndërmerren.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
HEKURAN ISAI

AQSH

Letër e dt 13.02.1991 nga Hekuran Isai drejtuar Ramiz Alisë

INFORMACION

## Letër e dt 13.02.1991 nga Hekuran Isai drejtuar Ramiz Alisë

| | |
|---|---|
| FONDI | 4 |
| STRUKTURA | Drejtoria e I-rë |
| DOSJA | 119 |
| VITET EKSTREME | 1991 |
| SASIA E FLETËVE | 50 |
| DATA E KRIJIMIT | 11.02.1991 |
| GJUHA | Shqip |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Informatë |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.